



NE FËMIJËT, JEMI LULET MË TË BUKURA



TË DREJTAT E BARABARTA

DRIN I. (10), YLLKA (11), HËNZA (11), ELTINA (10), SARA (11), SUADA (11), FLORIK (10), SHAIPI (10),
DRIN.K (10), ANDI (10), ZANA (10)



Votat e popullit, ndryshim i vendit demokratik. Ne si qytetarë duhet të jemi të përgjegjshëm

Nxënësit e klasës sonë patëm rastin që sot të jemi në rolin e gazetarëve. Ne jemi një nga grupet këtu në Punëtori që po e shkruajmë këtë artikull rreth demokracisë, prejardhjes së saj dhe për të drejtat tona në demokraci

Demokracia, fjalë e cila rrjedh nga gjuha greke, ku „demos“ do të thotë popull dhe „kratia“ udhëheqje. Prandaj, demokracia do të thotë udhëheqje nga populli.

Demokracia nga sot dhe kur është shfaqur për herë të parë ndryshon shumë. Kjo sepse të drejtën e vendimmarrjes nuk e kanë pasur të gjithë, por vetëm burrat e pasur. Në kohën që jetojmë sot, të gjithë i kemi të drejtat e barabarta. Pra, e kemi edhe të drejtën e vendimmarrjes. Siç e dijmë, në Kosovë gjatë procesit zgjedhor, votojnë sikurse burrat ashtu edhe gratë, pa dallime gjnore. Po ashtu, në shtetin tonë kemi pasur edhe një Presidentë e sot kemi edhe shumë deputete. Kjo tregon barazinë, e cila është një nga elementet themelore në demokraci.

Të gjithë fëmijët kanë të drejta të barabarta, të cilat janë të garantuara me ligj. Disa nga këto të drejta janë: e drejta e shkollimit, e drejta e lojës, e drejta e strehimit, e drejta e familjes, etj. Për shembull, të gjithë fëmijët kanë të drejtë të shkojnë në shkollë dhe të marrin njohuri pa kurrëfarë dallime.


Përveç që kemi mësuar për demokracinë, sot në

Punëtorinë e Demokracisë, ne edhe i kemi praktikuar elementet e saj. Kur dikush nga shokët apo shoqet ka folur, të gjithë e kemi dëgjuar dhe ia kemi respektuar mendimin. Sigurisht, jo gjithëherë kanë qenë mendime të njëjta, mirëpo në demokraci pranohen mendimet e llojllojshme. Pra, ne jemi të lirë të flasim atë që ne e mendojmë. Gjithashtu, edhe gjatë punës, kemi bashkëpunuar me njëri-tjetrin dhe jemi treguar mjaft të përkushtuar në punën tonë.

Mesazhi ynë për të gjithë është: të punojmë duke qenë të përgjegjshëm dhe të respektueshëm. Ne iu falenderojmë që lexuat këtë artikull të shkruar nga ne.



Grupi „Shqiponjat e Bashkuara“




Disa nga shokët dhe shoqet e klasës e pëlqejnë shumë futbollin. Ata/ato e kanë të drejtën e lojës



Në këtë vizatim është paraqitur një gazetar duke e intervistuar një qytetar



Po të jetojmë në një vend pa ligje, jeta do të ishte kaos. Lirinë dhe të drejtat që i kemi, nuk do të respektoheshin fare. Prandaj, ligjet janë shumë të rëndësishme dhe ato duhet të respektohen



Vendimet shumë të rëndësishme, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në jetën tonë, merren në Kuvend



Të drejtën për të zgjedhur përfaqësuesit e vendit, e kanë të gjithë qytetarët mbi moshën 18 vjeçare

KUVENDI, VENDI NË TË CILIN NE MBËSHTETEMI

ERZA (10), ARBËRESHA (11), VALSA (10), YLLMIR (11), LEART (10), ANILA (10), YLL (10), LEND (11),
ETRIT (10), FLORENTA (11)

KUVENDI SHTËPIA JONË

Qytetarët e Kosovës i kanë zgjedhur deputetët me anë të votave, me qëllim që ata të na përfaqësojnë neve denjësisht. Çdo shqetësim yni duhet të merret në konsideratë nga këta persona, të cilët punojnë në institucionin më demokratik të Kosovës, e që është Kuvendi

Sot ishte një ditë shumë e bukur dhe me diell. Ne e shfrytëzuam pikërisht këtë ditë që të vijmë për vizitë në organizatën TOKA. Ne u bëmë pjesë e Punëtorive të Demokracisë „Demos-ti“, ku mësuam shumë gjëra interesante. Demokracia pa dyshim që është temë kryesore, por në grupin e vogël ne folëm për Kuvendin, të cilin ndryshe e quajtëm „Shtëpia e Popullit“. Brenda kësaj shtëpie magjike, ndodhin shumë gjëra të rëndësishme, të cilat na prekin neve si qytetarë të shtetit të Kosovës.


Ligjet janë rregulla që na e sistemojnë jetën tonë. Këto ligje miratohen nga deputetët e Kuvendit të Kosovës, sepse atë kompetencë, ua japim ne si qytetarë me anë të votave tona.

Ne jemi më se të lumtur për ekzistencën e Kuvendit, sepse deputetët që punojnë aty, përpiqen shumë që ne të kemi një të ardhme të mirë.

Kosova fatkeqësisht ka një numër të madh të qytetarëve të papunë. Mirëpo, ne i zgjedhim personat e duhur si përfaqësues në mënyrë që ata t'i paraqesin të gjitha shqetësimet e qytetarëve në Kuvend.

Detyrë primare e deputetëve është që të na përfaqësojnë neve qytetarëve, pastaj të miratojnë ligje, ta kontrollojnë punën e Qeverisë, etj.

Këto informata që ne i morëm sot, na lumturuan shumë. Ne kuptuam që jemi ne ata të cilët vendosim për të mirën e shtetit tonë dhe atë e bëjmë me anë të votave.




Deputetja e Kuvendit me fjalimin e saj para kolegëve



Ne do të bëhemi përfaqësues të shtetit tonë

QYTETARËT E PËRGJEGJSHËM

ELENA (10), OLTA (10), ERBLIN (10), ILIR (10), DRIN (11), LISIAN (10), ART (11), ERMIRA (10),
ARTINA (10), MELISA (10)



Disa qytetarë aktiv sot me shumë dashuri dhe përkushtim kanë dhënë maksimumin e tyre që të gjitha ato informata që i kanë marrë për qytetarinë aktive t'i shkruajnë në këtë artikull

Barazia është një ndër elementet thelbësore të demokracisë. Fatkeqësisht, jo të gjithë qytetarët në botë e ndjejnë veten të barabartë me të tjerët. Ne si fëmijë që jemi, ndihemi shumë keq për këtë gjë. Kur ata nuk ndihen të barabartë, pa asnjë dyshim që edhe nuk mund të shprehemi lirshëm, të japim ide apo edhe gjëra të tjera. Mirëpo, demokracia na siguron të drejta të barabarta për të gjithë qytetarët, pa dallim.

Sigurisht se edhe qytetarët mund të jenë aktiv. Kur themi aktiv mendojmë veprimet përtej asaj çka ata janë të obliguar të bëjnë. Shembull: pagesa e taksave. Në një mënyrë kjo nuk është aktivizim, sepse nëse nuk e bëjmë pagesën atëherë dënohem sipas ligjit përkatës. Mirëpo ajo çka i dallon qytetarët aktiv është vullneti që kanë për të ndryshuar komunitetin ku jetojnë.

Ato që i cekëm më lart janë disa nga mënyrat se si ne kemi qenë aktiv, por tash do të flasim pak se si edhe qytetarët e tjerë mund të jenë aktiv.

Të gjithë ata të cilët janë mbi moshën 18 vjeçare kanë mundësi po ashtu të marrin pjesë në procesin zgjedhor, të nënshkruajnë peticione, të marrin pjesë në tubime publike, e shumë e shumë gjëra të tjera. Për të qenë aktiv nuk kërkon shumë. Mirëpo, kërkon vullnet e ne besojmë që të gjithë ju të dashur lexues keni vullnet për të bërë ndryshime pozitive në vendin tuaj. Kurrë mos e harroni këtë, ju lexues të kësaj gazete. Vetëm kështu vendi ynë ec përpara!

Ne, nxënësit e klasës së V-të sa e sa herë jemi treguar qytetarë aktiv. Zakonisht, këtë e bëjmë gjatë fundjavave. Të shtunat i kemi të mbushura me aktivitete që zhvillohen mes paraleleve të ndryshme, kurse të dielat janë për pastrim. Ky veprim më së shumti ndodh në fundjavë, por kjo nuk do të thotë që gjatë ditëve të javës nuk jemi aktiv. Çdo ditë, kur fillojmë mësimin në klasë bëhen edhe ndarja e detyrave. Në këtë mënyrë, secili prej nxënësve kontribuon dhe kujdeset që pjesa e detyrave të tij/saj të përfundoj në mënyrën më të mirë të mundshëm.

Kjo njëkohësisht është edhe përgjegjësi, por edhe kënaqësi për ne, sepse me punën tonë ndihet mirë i gjithë stafi i shkollës. Kjo na motivon që kurrë të mos ndalemi me punën tonë.



Qytetarët e vullnetshëm



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Pavarësia“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: V-1
Website: www.demos-ti.org Vendi: Prishtinë